



Datë: 21.08.2025

Numër Protokolli: 5646/2025

A.nr. 1211/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Flakron Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.1211/2025, të datës 24.06.2025, të parashtruar nga ankuesi J.K, nga Skenderaj, kundër organit të punësimit/Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafi 1, nën paragrafi, 1.1 dhe nenin 18, paragrafi 1, nën paragrafin 1.2, të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 21.08.2025, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar** ankesa A.nr.1211/2025, e datës 24.06.2025, e parashtruar nga ankuesi J.K.
- II. Anulohet** në tersi procedura e pranimit sipas konkursit me Nr. Reference: RN00017357 Grupi i Shkencave Shoqërore, për pozitën e punës “*Inspektor i Tregut*”, i shpallur nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, si dhe çdo veprim tjetër i rrjedhë nga kjo procedurë,
- III. Obligohet** Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore e Agjencisë Pyjore të Kosovës, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi, brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të tij, duke ndërmarr të gjitha veprimet si në pikën II të dispozitivit.
- IV.** Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim për veprimet e ndërmarra.

A r s y e t i m

Kandidati për pranim në shërbimin civil, J.K (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi), me datë 24.06.2025, ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Njoftimit për kandidatët fitues me shifër Nr.2126 të datës 03.06.2025, të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, në konkursin me Nr. Reference RN00017357-Grupi i Shkencave Shoqërore, për

pozitën Inspektor i Tregut, i shpallur nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, (*tani e tutje referuar MINT*).

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 01.07.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek MINT, ndërsa kjo e fundit me datë 02.07.2025, ka dorëzuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritore administroi këto prova: Ankesën me numër protokoli 4308/2025 të datës 24.06.2025 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Konkursin RN00017357 të datës 24.03.2025; Njoftimin e datës 03.04.2025; Njoftimin e datës 20.05.2025; Njoftimin e datës 29.05.2025; Njoftimin e datës 03.06.2025; Njoftimin e datës nr.2055/2025 të datës 29.05.2025; Njoftimin për kandidatët fitues i datës 03.06.2025; E-mailin e datës 24.05.2025 dërguar nga ankuesi në Këshill; Kopjen e letërnjoftimit të ankuesit; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 02.07.2025; Shkresë e DMZP-së e datës 22.03.2025; Vendimin e datës 05.05.2025 të UD. Sekretares së Përgjithshme të MINT me akt emërimet e anëtarëve të komisionit; Vendimin e datës 16.05.2025 të UD. Sekretares së Përgjithshme të MINT; Vendimin e datës 22.11.2024 të UD. Sekretares së Përgjithshme të MINT; Aplikacionin e ankuesit të datës 03.04.2025 me dokumentacionin e bashkangjitur; Aplikacionin e kandidatit I.B të datës 28.03.2025 me dokumentacionin e bashkangjitur; Aplikacionin e kandidatit K.Xh të datës 03.04.2025 me dokumentacionin e bashkangjitur; Aplikacionin e kandidatit Z.T të datës 22.04.2025 me dokumentacionin e bashkangjitur; Testet me shkrim; Formularët e vlerësimeve individuale të anëtarëve të komisionit për kandidatët në procedurë; Formularin e renditjes përfundimtare të kandidatëve në procedurë; E-mailin e datës 21.07.2025 dërguar nga Njësia e Burimeve Njerëzore e MINT në Këshill me Vendimet përkatëse për Caktimin e Ushtruesve të Detyrës së pozitës së Sekretarit të Përgjithshëm të MINT; E-mailin e datës 01.08.2025 dërguar nga Këshilli për A.B.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi se ankesa e ankuesit ***është e bazuar, sepse:***

Nga administrimi i shkresave të lëndës, Kolegji i Këshillit, ka konstatuar se MINT, më datë 24.03.2025 ka shpallur konkursin me Nr. Reference: RN00017357, Grupi i Shkencave Shoqërore, për pozitën e punës “*Inspektor i Tregut*”, numri i kërkuar shtatë (7) pozita, klasa e pozitës profesionale 1, me afati aplikimi nga data 25.03.2025 deri më datë 23.04.2025.

Tutje, nga shkresat e lëndës rezulton se në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesi, ndërsa sipas njoftimit të datës 07.05.2025, e njëjta e ka kaluar fazën e verifikimit paraprak e cila i është nënshtruar testimit me shkrim, mirëpo sipas Njoftimit të datës 29.05.2025 të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, ankuesi është njoftuar se ka marr vetëm 21.8 pikë të cilat nuk ka qenë të mjaftueshme për të kaluar testin me shkrim nga 50 pikë sa është e nevojshme për të vazhduar në procedurën e rekrutimit, respektivisht intervistës me gojë, sikurse përcaktohet me dispozitat e aplikuara nga Rregullore (Qrk) Nr. 15/2023 Për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, neni 10 paragrafi 2 ku përcaktohet se: “2. Vetëm kandidatët që

kanë marrë të paktën pesëdhjetë (50) pikë në testimin me shkrim, kanë të drejtë të marrin pjesë në intervistë.”, ndërsa sipas Njoftimit të datës 03.06.2025 për vlerësimin përfundimtar të kandidatëve, pas kryerjes së intervistimit më gojë, rezultoi se kandidatët që ka marrë pikë të mjaftueshme, janë kandidati Z.T me gjithsejtë 86.2 pikë, kandidati K.Xh me gjithsejtë 85.2 pikë, kandidati I.G me gjithsejtë 78.4 dhe kandidati I.B me gjithsejtë 77 pikë, të cilët rezultojnë të jenë edhe kandidatë të suksesshëm në procedurën përkatëse të rekrutimit.

Ankuesi në ankesën e parashtruar përmes postës në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, kundër Njoftimit të datës 03.06.2025 për kandidatët e suksesshëm në procedurë, pretendon se gjatë procedurës në fjalë ka pasur shkelje procedurale dhe substanciale të ligjit material të cilat kanë ndikuar drejtpërdrejtë në rezultatin përfundimtar dhe cenimin e të drejtave të mia, me theksin se testi nuk ka reflektuar përmbajtjen dhe kërkesat specifike të përshkrimit të punës për pozitën e shpallur, janë shkelur neni 6 dhe 7 i Rregullores për procedurat e rekrutimit, përbërja e komisionit nuk ka qenë në përputhje me legjislacionin si dhe nuk ka pasur profesionist të fushës në përbërje që ka ndikuar në vlerësimin jo objektiv të testit, mungesë transparence dhe komunikimi procedural, me kërkesën që Këshilli të aprovoi ankesën ashtu që të shqyrtoi ligjshmërinë e tërë procedurës së rekrutimit.

Kolegji i Këshillit, lidhur me këtë çështje ankimore ka analizuar aktin e shpalljes së kësaj pozite, respektivisht sipas konkursit me Nr. Reference: RN00017357, Grupi i Shkencave Shoqërore, për pozitën e punës “*Inspektor i Tregut*” dhe ka konstatuar se kërkesa të përgjithshme formale në procedurën përkatëse të rekrutimit kanë qenë: **Arsimimi i kërkuesit:** *Diplomë e arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor). Fakulteti Juridik, Ekonomik (pa specifikim), Sociologji, Antropologji, Filozofi, Histori, Shkenca Politike, Psikologji, Punë Sociale, Gjeografi, Administratë Publike; Përvoja e punës e kërkuesit:* *Së paku dy (2) vite përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.*

Kolegji i Këshillit, konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është institucion i pavarur kushtetues që siguron respektimin e rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil dhe këtë e bënë përmes dy funksioneve të përcaktuara sipas nenit 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe 1.3 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet: “1. Për mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil, Këshilli ka këto funksione themelore: 1.1. shqyrton dhe merr vendime për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në shërbimin civil; 1.3. monitoron institucionet e administratës publike që kanë të punësuar nëpunës civil, lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil”, e për rrjedhojë mbi bazë të këtij kuadri ligjor, dhe duke marrë për bazë pretendimin ankimor të ankueses që të shqyrtohet ligjshmëria e procedurës së rekrutimit, Kolegji i Këshillit, e shqyrtoi në tersi procedurën e pranimit sipas konkursit me RN00017357, Grupi i Shkencave Shoqërore, për pozitën e punës “*Inspektor i Tregut*”, nga iniciimi i procedurës së pranimit deri në përfundimin e saj.

Duke marrë për bazë edhe lëndë të tjera pranë Këshillit, ku palë në procedurë është organi përkatës i punësimit, respektivisht Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, zyrtari i autorizuar në lëndë përkatëse me datë 18.07.2025 i është drejtuar Njesisë së Burimeve Njerëzore të MINT me kërkesën si në vijim: “Ju lutem më njoftoni nga cila datë është e lirë pozita e Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e

*Industrië, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, rrjedhimisht bashkangjitni të gjitha Vendimet për caktimin e Zëvendësuesve, gjegjësisht Ushtruesve të Detyrës për pozitën e Sekretarit” ndërsa Njësia e Burimeve Njerëzore e MINT me datë 21.07.2025 ka kthyer përgjigjen si në vijim: “Në vijim të kërkesës suaj, ju njoftojmë lidhur me mbulimin e pozitës së Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Industrië, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT). Pozita e Sekretarit të Përgjithshëm ka qenë e mbuluar me ushtrues detyre (u.d.) në këto periudha: **Nga data 25.02.2020 deri më 22.06.2020 dhe Nga data 10.09.2020 e tutje, pozita ka vazhduar të jetë e mbuluar përmes emërimit të ushtruesit të detyrës, dhe ky status mbetet ende në fuqi.** Vendimet përkatëse që dëshmojnë periudhat e emërimit të ushtruesve të detyrës janë të bashkëngjitura këtij komunikimi për informim dhe referencë tuajën”.*

Po ashtu, Kolegji i Këshillit, konstaton se U.D. Kryeinspektorja e Inspektoratit të Tregut me datë 21.03.2025 i është drejtuar Udhëheqëses së Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të MINT për hapjen e procedurës së rekrutimit për inspektorë të rinj, ndërsa U.D. Sekretarja e Përgjithshme e MINT, përmes emailit të datës 25.03.2025 e ka udhëzuar Udhëheqësen e Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të MINT që të hapen pozitat e lira të miratuara dhe buxhetuara sipas legjislacionit në fuqi, andaj në konstatimin e Kolegjit të Këshillit emaili i datës 25.03.2025 e ka karakterin e aktit konfirmues apo aprovimin për hapjen e konkursit për pozitat “Inspektor i Tregut” sipas kërkesës së datës 21.03.2025 të U.D. Kryeinspektorese së Inspektoratit të Tregut.

Mbi bazën e konstatimeve të dhëna si më lartë Kolegji i Këshillit thekson faktin se Ligji Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, i cili ka hyrë në fuqi nga data 25 shtator 2023, dhe si pasojë me hyrjen në fuqi të këtij ligji, marrëdhëniet e punës e në veçanti çështjet lidhur me caktimin e ushtruesit të detyrës në shërbimin civil duhet të behen në pajtim me dispozitat e nenit 35 të këtij ligj, e më të cilat dispozita është përcaktuar se : *1.Në rast se një pozitë e nivelit drejtues brenda strukturës organizative të institucionit mbetet e lirë, nëpunësja/i i nivelit të lartë drejtues e atij institucioni e cakton me vendim ushtruesen/in e detyrës për pozitën e lirë e pajtim me paragrafin 1. të këtij neni, ushtruesja/i i detyrës mund të caktohet zyrtarja/imë i lartë i kategorisë pasuese, në varësi të pozitës që caktohet, nga cilado njësi organizative brenda institucionit. 3. Zyrtarja/i publik nuk mund të caktohet si ushtruese/i detyre më gjatë se gjashtë (6) muaj. Kur pozita nuk mund të plotësohet brenda afatit gjashtë (6) muaj, ky afat mund të zgjas më së shumti edhe për gjashtë (6) muaj të tjerë. 4. Pozita e lirë nuk mund të zëvendësohet me ushtrues detyre për më gjatë se afati i përcaktuar në paragrafin 3. të këtij neni. 5. Çdo vendim i marrë nga ushtruesja/i i detyrës, pas kalimit të afatit të përcaktuar në paragrafin 3. të këtij neni, është i paligjshëm”*, andaj, duke qenë se me hyrjen në fuqi të këtij ligji pozita e Sekretarit të Përgjithshëm të MINT ka qenë e lirë dhe e njëjta ka qenë duke u ushtruar me zëvendësues, respektivisht me datë 19.05.2023 Ministria e MINT përmes Vendimit me shifër:2898/0/ e ka emëruar D.L., Zëvendësues të Sekretarit të Përgjithshëm të MINT, pastaj e njëjta përmes Vendimit Nr.1-478/1 të datës 03.02.2024 e ka emëruar S.B, Ushtruese të Detyrës së Sekretarit të Përgjithshëm të MINT, më pastaj përmes Vendimit Nr:1-1138/01 të datës 04.11.2024 është caktuar Q.A, Ushtruese e Detyrës së Sekretarit të Përgjithshëm të MINT, kurse së fundi përmes Vendimit Nr:1-478/01 të datës 03.05.2025 është caktuar S.I, Ushtruese e Detyrës së Sekretarit të Përgjithshëm të MINT, nga rrjedh se sipas shkresave të lëndës Kolegji i Këshillit ka arritur të konstatoi se pozita e Sekretarit të Përgjithshëm të MINT, është mbuluar me zëvendësues apo ushtrues detyre në një periudhë prej më shumë se pesë (5) vitesh, ndërsa pas hyrjes në fuqi të Ligji Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, që nga data 25 shtator 2023 e njëjta pozitë ka qenë duke u ushtruar me zëvendësues apo ushtrues detyre prej më shumë

se (1) një viti, respektivisht një (1) viti e dhjetë (10) muajsh, deri në momentin e nxjerrjes së këtij vendimi nga ana e Këshillit, dhe mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit, konstaton se pozita e Sekretarit të Përgjithshëm të MINT, pas datës 25.09.2024 ka qenë duke u ushtruar me ushtrues detyrë në kundërshtim të plotë me nenin 35 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë.

Duke qenë se sipas dispozitave të cekura më lartë një pozitë drejtuese nuk mund të mbahej me ushtrues detyrë më gjatë se një vit, atëherë më datë 25.09.2024, ka kaluar afati prej një viti (1) i ushtruesit të detyrës së pozitës së Sekretarit të Përgjithshëm të MINT, kështu që në kuadër të kësaj Kolegji i Këshillit, konstaton se çdo vendim i marrë nga ushtruesja/i i detyrës, pas kalimit të afatit prej një viti është i paligjshëm, atëherë në këtë kontekst aprovimi i shpalljes së konkursit me datë 25.03.2025 si dhe nxjerrja e Vendimit të datës 05.05.2025 për themelimin e Komisionit të Pranimi i plotësuar dhe ndryshuar sipas Vendimit të datës 16.05.2025, janë të paligjshme sepse janë aprovuar respektivisht nxjerr nga zyrtari në cilësi të ushtruesit të detyrës Sekretarit të Përgjithshëm në MINT, pozitë kjo që është ushtruar në mënyrë të kundërligjshme nga data 25.09.2024 e deri në përfundimin e këtij konkursi.

Lidhur me konstatimet e dhëna si më lart, Kolegji i Këshillit mori për bazë konstatimet e Gjykatës Supreme, të dhënë si në Aktgjykimin P.A.nr.07/2025, të datës 10.06.2025 dhe të publikuar në gazetën zyrtare më datë 03.07.2025, ku ndër të tjera Gjykata Supreme ka konfirmuar se: *...Nga kjo dispozitë rrjedh qartë se çdo akt juridik i nxjerrë nga një udhëheqës në cilësinë e ushtruesit të detyrës pas skadimit të afatit prej një viti është i pavlefshëm në thelb, për shkak të mungesës së kompetencës ligjore për të ushtruar funksionet që burojnë nga ajo pozitë..... Ligji i referohet pozitës si funksion institucional dhe jo individit si person. Pra, ndërrimi i personit nuk e ndërpret dhe nuk e rifillon afatin gjashtë mujor, përkatësisht njëvjeçar të ushtrimit të përkohshëm të pozitës. Kjo qasje është në përputhje me frymën e ligjit që kërkon stabilitet, profesionalizëm dhe përgjegjësi institucionale në udhëheqjen publike.*

Në mbështetje të konstatimit të dhënë si më lartë, gjegjësisht, duke qenë së aprovimi i shpalljes së procedurës së rekrutimit dhe emërimi i Komisionit të Pranimi nuk ka qenë në pajtim me kërkesat ligjore, atëherë Kolegji i Këshillit rithekson faktin se institucionet e administratës publike janë të obliguara ta zbatojnë Ligjin Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme, respektivisht dispozitat e nenit 4, ku përcaktohet se: *“1. Organet publike veprojnë në përputhje me Kushtetutën, legjislacionin në fuqi, si edhe me rregullat e përgjithshme administrative të zbatueshme brenda kompetencave të tyre dhe në përputhje me qëllimin për të cilat janë dhënë këto kompetenca. 2. Veprimi administrativ që cenon apo mund të cenojë një të drejtë apo interes juridik të një personi, duhet të jetë i autorizuar nga një ligj”,* e në këtë rast ushtruesi i detyrës së Sekretarit të Përgjithshëm të MINT, ka vepruar pa kompetencë, andaj edhe procedura e pranimi sipas konkursit me Nr. Reference: RN00017357, Grupi i Shkencave Shoqërore, për pozitën e punës *“Inspektor i Tregut”*, të shpallur nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë , është e paligjshme në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, 1.2, 1.3, 1.4, 1.5, 1.6 dhe 1.7 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: *1. Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: 1.1. është nxjerrë në mungesë të autorizimit nga një ligj, sipas paragrafit 2 të nenit 4 të këtij Ligji; 1.2. organi publik që e nxjerr ka vepruar pa pasur kompetencë; 1.3. është rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative; 1.4. është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën apo elementet e detyrueshme të aktit administrativ; 1.5. është në kundërshtim me ligjin material; 1.6. është rezultat i diskrecionit që është ushtruar në mënyrë jo të ligjshme, apo 1.7. nuk është*

në pajtim me parimin e proporcionalitetit". Kolegji i Këshillit, konstaton se sipas këtyre rrethanave, vendosi të aprovojë ankesën e ankuesit, të anuloi në tersi procedurën e pranimit sipas konkursit me Nr. Reference: RN00017357, dhe si rrjedhojë çdo veprim tjetër administrativ i ndërmarr nga kjo procedurë, ndërsa në pajtim me dispozitivin dhe arsyetimin e këtij vendimi Njësia e Burimeve Njerëzore e MINT është e obliguar të publikoi njoftimin për anulimin e konkursit përkatëse sipas vendimmarrjes nga an e Këshillit.

Prandaj përkitazi me konstatimet e dhëna si më lartë, Kolegji i Këshilli thekson fakti nuk u lëshua në shqyrtimin e pretendimeve të tjera ankimore të ankuesit, ngase konstatimi apo jo i tyre nuk do të ndryshonte natyrën e vendimmarrjes si në këtë vendim, respektivisht ankesa e ankuesit është aprovuar vetëm mbi bazën e konstatimeve të dhëna si më lartë.

Kështu që pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.1211/2025, datë 21/08/2025

Flakron GASHI

Procesmbajtës

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit J.K;
- Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme;
- Njesisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Industrisë dhe Ndërmarrësisë; si dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.